



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE FIER
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ .02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale elektrike per ndricim rrugor”

Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Materiale elektrike 31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT/ vlera e pritshme : 14,997,621.15 (katërmëdhjetë milionë e nentëqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e një pike pesëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues eshte ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te percaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të*

tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit¹. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se **14 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë që nuk tejkalon vlerën e përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic

është parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve mesatare të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik, për të mundësuar pjesëmarrje me të gjere të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **5 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; **ose/dhe,**

ii. Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **5 000 000 lekë pa TVSH** *(e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet)* që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”

Specifikimet teknike janë vendosur referuar materialit të hartuar nga grupi i punës i ngritur pranë Ndermarjes së Shërbimeve Publike Fier dhe dërguar me nr.85 prot., datë 05.02.2026 me lende:Kerkese per prokurim ,Marreveshje kuader 24-mujore, protokolluar pranë Bashkisë Fier me shkresën nr.1702 prot., datë 06.02.2026 si dhe shkresën me nr.57/3 prot., datë 26.01.2026 mbi ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike, si dhe shkresën me nr.57/5 prot., datë 29.01.2026 nga grupi i punës për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike bashkëngjitur DST në SPE.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

Njësia e prokurimit: